



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

---

Legjislatura IV  
Sesioni pranveror

Mbledhja plenare e Kuvendit  
P- 60  
Prishtinë, më 10 maj 2012

**PROCESVERBAL**

**IMBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, TË  
MBAJTUR MË 10, 11 DHE 15 MAJ 2012**

Mbledhjen e drejtoi kryetari **Jakup KRASNIQI**, ndërsa i ndihmoi nënkryetari **Xhavit HALITI**.

Kryetari i deklaroi të hapura punimet e mbledhjes plenare.

Në fillim të mbledhjes, për fjalë u paraqitën deputetët: Zenun Pajaziti, Ismet Beqiri dhe Ali Sadriu.

**Zenun Pajaziti**, në emër të Komisionit Parlamentar për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, propozoi që rendi i ditës së mbledhjes së sotme të plotësohet edhe me pikën - **Shqyrtimi i Propozim-vendimit të Qeverisë së Kosovës për emërimin e anëtarëve në Bordin e Zyrës së Rregullatorit të Energjisë**.

**Ismet Beqiri**, në emër të GP të LDK-së, propozoi që nga rendi i ditës së mbledhjes së sotme plenare të hiqet pika - **Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për teatrot**, me arsyetimin se komuniteti i artistëve ka bërë propozime për këtë projektligj, që duhet të merren parasysh.

**Ali Sadriu**, në emër të Komisionit Parlamentar për Mbikëqyrjen e Financave Publike, propozoi që nga rendi i ditës së mbledhjes së sotme plenare të hiqet pika - **Shqyrtimi i raportit të punës të Radio-Televizionit të Kosovës, për vitin 2011**.

Lidhur me propozimet e lartpërmendura, kryetari kërkoi deklarinimin e kryetarëve të grupeve parlamentare dhe të kryetarëve të komisioneve përkatëse funksionale.

Për propozimet e lartpërmendura diskutuan deputetët: Adem Grabovci, Visar Ymeri, Ardian Gjini, Myzejene Selmani, Sasha Milosavleviq, Fikrim Damka, Idriz Vehapi, Alma Lama, Safete Hadergjonaj dhe Arben Gashi, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

**Kryetari** kërkoi nga deputetët që të deklarohen nëpërmjet votimit elektronik, për propozimin e deputetit Zenun Pajaziti.

Kryetari konstatoi se Kuvendi e miratoi propozimin që **Shqyrtimi i Propozim-vendimit të Qeverisë së Kosovës për emërimin e anëtarëve në Bordin e Zyrës së Rregullatorit të Energjisë** të radhitet si pikë e fundit e rendit të ditës të kësaj mbledhjeje.

Në vazhdim, **kryetari** kërkoi nga deputetët të deklarohen nëpërmjet votimit elektronik për propozimin e deputetit Ismet Beqiri.

Kryetari konstatoi se Kuvendi e miratoi propozimin e deputetit Ismet Beqiri për heqjen nga rendi i ditës - **Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për teatrot.**

Më pas, **kryetari** kërkoi nga deputetët që të deklarohen nëpërmjet votimit elektronik për propozimin e deputetit Ali Sadriu.

Kryetari konstatoi se Kuvendi e miratoi propozimin e deputetit Ali Sadriu, për heqjen nga rendi i ditës - **Shqyrtimi i raportit të punës të Radio-Televizionit të Kosovës, për vitin 2011.**

Në vazhdim, Kuvendi i zhvilloi punimet me këtë:

## **R e n d i t e**

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mëparshme,
4. Interpelancë me zëvendëskryeministren Edita Tahiri lidhur me fatin e të zhdukurve në raport me bisedimet me Serbinë, në Bruksel, sipas kërkesës së Grupit të deputetëve nënshkrues,
5. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për marrëdhëniet e detyrimeve,
6. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për skemën e ndihmës sociale në Kosovë,
7. Shqyrtimi i raportit vjetor financiar për buxhetin e Republikës së Kosovës, për vitin 2011,
8. Shqyrtimi i raportit të punës të Institutit Gjyqësor të Kosovës, për vitin 2011,
9. Shqyrtimi i raportit të punës të Komisionit të Pavarur të Medieve, për vitin 2011,
10. Shqyrtimi i raportit të punës të Agjencisë Kosovare Kundër Korrupsionit, për vitin 2011,
11. Shqyrtimi i propozimit të Gjykatës Supreme të Kosovës për emërimin e anëtarit në Komisionin për Kërkesa Pronësore,
12. Shqyrtimi i propozimit të Qeverisë së Kosovës për emërimin e anëtarit të Bordit të Agjencisë Kosovare të Pronës,

13. Shqyrtimi i kërkesës së Komisionit ad hoc për amendamentimin e Ligjit për zgjedhjet e përgjithshme, për afat shtesë.
14. Kërkesa e Komisionit për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, për afat shtesë për ta shqyrtuar Projektligjin për parkun kombëtar “Sharri” dhe atë për parkun kombëtar “Bjeshkët e Nemuna”.
15. Shqyrtimi i Propozim-vendimit të Qeverisë së Kosovës për emërimin e anëtarëve në Bordin e Zyrës së Rregullatorit të Energjisë.

## **1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës**

Deklarime jashtë rendit të ditës paraqitën deputetët: Arben Gashi, Berat Buzhala, Liburn Aliu, Donika Kadaç-Bujupi, Hashim Dëshishku, Myzejene Selmani, Njazi Idrizi, Albana Gashi, Time Kadriaj dhe Arsim Bajrami, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

## **2. Koha për pyetje parlamentare**

Deputetja Nazane Breca parashtoi pyetje për ministrin Ramë Buja në lidhje me kriteret që i ka përdorur Ministria që ai e drejton për hapjen e ambulancave në disa shkolla fillore dhe të mesme në Kosovë.

Ministri Ramë Buja iu përgjigj pyetjes së deputetes Nazane Breca.

Deputetja Nazane Breca parashtoi pyetje për ministrin Ramë Buja, në lidhje me atë se cili ligj do të aplikohet për drejtorët e shkollave në Kosovë?

Ministri Ramë Buja iu përgjigj pyetjes së deputetes Nazane Breca.

Deputeti Ramiz Kelmendi parashtoi pyetje për ministrin Fehmi Mujota, në lidhje me planin organizativ për shfrytëzimin e Portit të Shëngjinit.

Ministri Fehmi Mujota iu përgjigj pyetjes së deputetit Ramiz Kelmendi.

Deputetja Alma Lama parashtoi pyetje për ministren e Integrimeve, Vlora Çitaku, në lidhje me atë se a ka ndërmarrë masa Ministria që ajo e drejton për riatdhesimin e fëmijëve të kthyer nga Gjermania dhe Austria, në veçanti të komunitetit rom.

Ministrja e Integrimeve, Vlora Çitaku, iu përgjigj pyetjes së deputetes Alma Lama.

Deputetja Alma Lama parashtoi pyetje për ministrin Ramë Buja, në lidhje me transparencën gjatë hartimit të Projektligjit për veprimtari kërkimore-shkencore.

Ministri Ramë Buja iu përgjigj pyetjes së deputetes Alma Lama.

## **3. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes plenare, të mbajtur më 3 maj 2012**

Kuvendi e miratoi pa vërejtje procesverbalin e mbledhjes plenare të datës 3 maj 2012.

Deputetja Blerta Deliu-Kodra kërkoi që në faqen elektronike të Kuvendit të saktësohen të dhënat lidhur me përkatësinë partiake të saj.

Ndërsa deputetja Sala Berisha-Shala kërkoi që në transkriptin e mbledhjeve plenare të përfshihet rendi i ditës.

#### **4. Interpelancë me zëvendëskryeministren Edita Tahiri lidhur me fatin e të zhdukurve në raport me bisedimet me Serbinë, në Bruksel, sipas kërkesës së Grupit të deputetëve nënshkrues**

Para se të fillojë shqyrtimi i kësaj pike, për fjalë u paraqit deputeti Ismet Beqiri.

**Ismet Beqiri**, në emër të GP të LDK-së, tha se në mbledhjen plenare, të mbajtur më 3 maj 2012, Kuvendi ka vendosur që rekomandimet për debatin parlamentar lidhur me çështjen e personave të zhdukur të riformulohen dhe të procedohen për votim në mbledhjen plenare të radhës. Ai kërkoi që ato rekomandime, pasi janë të harmonizuara, të procedohen për votim në mbledhjen e sotme.

**Kryetari** propozoi që rekomandimet lidhur me debatin parlamentar për çështjen e personave të zhdukur të hedhen në votim menjëherë pas përfundimit të pikës nr. 4 të rendit të ditës të mbledhjes së sotme plenare.

Kuvendi u pajtua me propozimin e lartpërmendur të kryetarit.

Në vazhdim, **kryetari** i njoftoi deputetët se Grupi i deputetëve nënshkrues ka parashtruar kërkesë për interpelancë me zëvendëskryeministren Edita Tahiri lidhur me fatin e të zhdukurve në raport me bisedimet me Serbinë, në Bruksel.

Ai, më tej, i njoftoi deputetët për kohëzgjatjen e interpelancës, prej tri orësh, si dhe për kohën e ndarë për secilin grup parlamentar, në bazë të vendeve që kanë në Kuvend, dhe për deputetët pa grup parlamentar, e cila është përcaktuar në bazë të Rregullores së Kuvendit.

Kryetari e ftoi propozuesin e interpelancës ta marrë fjalën.

Deputetja **Kymete Bajraktari**, në emër të Grupit të deputetëve nënshkrues, tha se tashmë po bëhen 13 vjet nga zhdukja e personave nga lufta në Kosovë, trupat e të cilëve regjimi okupues i hodhi në varreza masive në Kosovë, e disa mijëra të tjerë i mori me vete dhe i hodhi nëpër lumenj dhe nëpër varreza masive në Serbi.

Në vazhdim, deputetja Kymete Bajraktari theksoi se përderisa gjatë këtyre 13 vjetëve shteti serb asnjëherë nuk ka treguar vullnet e as gatishmëri për zbardhjen e fatit të të zhdukurve nga lufta në Kosovë, në anën tjetër Qeveria e Republikës së Kosovës e ka filluar procesin e bisedimeve me Serbinë, në Bruksel, para më shumë se një viti.

Më tej, ajo u fokusua në mungesën e plotë të informacioneve për trajtimin e çështjes së të zhdukurve nga lufta në Kosovë, në bisedimet me Serbinë, në Bruksel, nga zëvendëskryeministrja Edita Tahiri.

Më pas, ajo kërkoi që çështja e të zhdukurve nga lufta në Kosovë të kushtëzohet në bisedimet e ardhshme ndërshtetërore Kosovë- Serbi, në Bruksel.

Në fund të fjalës së saj, deputetja Kymete Bajraktari e paraqiti para deputetëve të Kuvendit tekstin e mocionit që propozohet për votim.

Diskutimi i plotë i deputetes **Kymete Bajraktari** është dhënë në transkript.

Zëvendëskryeministrja **Edita Tahiri** tha se çështja e personave të pagjetur nga lufta në Kosovë paraqet njërën prej plagëve më të rënda të agresionit serb nga koha e luftës.

Në vazhdim ajo theksoi se Qeveria e Republikës së Kosovës ka pasur për synim që çështjen e të zhdukurve ta ngrejë në nivel të agjendës së BE-së.

Më tej, zëvendëskryeministrja tha se më 18 maj 2011, në kuadër të bisedimeve teknike Kosovë-Serbi, në Bruksel, kemi diskutuar për çështjen e të zhdukurve, me ç'rast edhe në prani të faktorit ndërkombëtar kemi paraqitur tetë pika, të cilat ajo i lexoi në vazhdim.

Më pas, ajo tha se Qeveria e Republikës së Kosovës ia ka dorëzuar Bashkimit Evropian të gjitha materialet për të pagjeturit.

Pastaj ajo u fokusua në veprimtarinë dhe bashkërendimin e mekanizmave vendorë, të themeluar për çështjen e të pagjeturve në Kosovë.

Në fund të fjalës së saj, zëvendëskryeministria Edita Tahiri tha se Qeveria e Kosovës është e vetëdijshme për kompleksitetin dhe ndjeshmërinë e kësaj çështjeje, por se angazhimi do të jetë maksimal, në mënyrë që fati i të zhdukurve të zbardhet sa më parë që të jetë e mundur.

Diskutimi i plotë i zëvendëskryeminstres Edita Tahiri është dhënë në transkript.

Kryetari e hapi diskutimin lidhur me interpelancën me zëvendëskryeministren Edita Tahiri.

**Shaip Muja**, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, tha se çështja për të cilën po debatojmë sot në Kuvend është mjaft komplekse dhe e vështirë, ngase në kontekst të luftës së fundit në Kosovë ishin 6010 persona të pagjetur, prej të cilëve 1781 persona ende vazhdojnë të mbeten të tillë.

Në vazhdim, deputeti Muja vuri në pah mosgatishmërinë e shtetit serb për ndriçimin e fatit të të zhdukurve, duke e ilustruar këtë me një deklaratë të kryeparlamentarit të Kuvendit të Serbisë, të bërë më 9 maj 2010, për gjetjen e 250 mbetjeve mortore në një varrezë masive në Serbi, për të cilat ai asokohe kishte deklaruar se së shpejti do të fillojë procesi i identifikimit, por as edhe pas dy vjetësh nga ky deklaram, asgjë nuk ka lëvizur në drejtim të zbardhjes së fatit të këtyre personave.

Pastaj ai u angazhua që në bisedimet ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, në Bruksel, çështja e personave të pagjetur të bëhet prioritet i bisedimeve.

Në fund, deputeti Shaip Muja paraqiti para deputetëve disa pika të që duhet të harmonizohen me tekstin e mocionit të paraqitura nga Grupi i deputetëve nënshkrues, lidhur me zbardhjen e fatit të të pagjeturve.

**Rita Hajzeraj-Beqaj**, në emër të Grupit parlamentar të LDK-së, tha se për një çështje të tillë çfarë është ajo e fatit të të pagjeturve nga lufta në Kosovë, është mirë që zëvendëskryeministria Edita Tahiri po raporton para deputetëve të Kuvendit, por angazhimi i Qeverisë së Kosovës, në përgjithësi, është i pamjaftueshëm në raport me këtë çështje.

Në vazhdim, ajo kërkoi të dijë më shumë për rezultatet e bisedimeve për të pagjeturit ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, në Bruksel, për ç'gjë, sipas zëvendëskryeminstres Edita Tahiri, takimi është mbajtur më 18 maj 2011.

Më pas, deputetja Rita Hajzeraj-Beqaj kërkoi që të gjitha institucionet shtetërore të Kosovës t'u përmbahen vendimeve dhe akteve tjera të Kuvendit të Kosovës për zbardhjen e fatit të të pagjeturve.

**Albin Kurti**, në emër të Grupit Parlamentar "Vetëvendosje", fillimisht tha se ajo çka është vërejtur deri më tani është se të gjitha qeveritë në Kosovë, që nga paslufta, nuk kanë bërë shumë për zbardhjen e fatit të të pagjeturve.

Në vazhdim, deputeti Albin Kurti theksoi se deri më tani në bisedimet Kosovë-Serbi, në Bruksel, janë arritur tetë marrëveshje, ndërsa çështja e të pagjeturve nuk figuron në asnjërën nga këto marrëveshje.

Në vend të presionit mbi Serbinë për të pagjeturit, Serbia këtë çështje - pra krimet e veta, e ka kthyer në favor të negociatave me Kosovën, konstatoi ai.

Më pas, deputeti Albin Kurti u fokusua në aktivitetet e Qeverisë së Kosovës në raport me çështjen e të pagjeturve, angazhime këto të cilat ai i quajti si të papërgjegjshme.

**Kymete Bajraktari**, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, tha se numri i madh i personave ende të pagjetur është një simbolikë, e cila tregon se rendi dhe ligji nuk janë duke funksionuar si duhet.

Në vazhdim, duke u ndërlidhur me paraqitjen e zëvendëskryeministres Edita Tahiri lidhur me çështjen e personave të pagjetur, ajo vuri në dilemë çështjen e suksesit për zbardhjen e fatit të këtyre personave, duke e shtruar pyetjen: Cilat janë rezultatet konkrete për këtë çështje nga bisedimet Kosovë-Serbi, të mbajtura në Bruksel?

Më tej, duke folur për prioritetet e marrëveshjeve të arritura ndërmjet Kosovës dhe Serbisë në Bruksel, ajo e shtroi çështjen se çka është më e rëndësishme dhe çka do të duhej të ishte prioritet; marrëveshja e arritur për targarat, marrëveshja e arritur për kopjet e regjistrave të ndryshëm, apo marrëveshja e cila do të duhej arritur për zbardhjen e fatit të të pagjeturve?

**Myzejene Selmani**, në emër të Grupit Parlamentar Kosova e Re, kërkoi që të bëhet çmos për ndriçimin e fatit të të pagjeturve, duke qenë të bindur se një gjë e tillë nuk bëhet me deklaratat, por me veprime konkrete, në mënyrë që ankthi dhe pritjet për familjarët e të pagjeturve të marrin fund sa më parë që të jetë e mundur.

Ajo më tutje u angazhua që çështja e të pagjeturve të ngrihet në nivel të mekanizmave të OKB-së nga ministri i Punëve të Jashtme i Republikës së Kosovës.

**Jasmina Zhivković**, në emër të Grupit Parlamentar SLS, tha se kjo temë po kthehet përsëri për diskutim në Kuvend, por si e tillë po shihet në mënyrë të njëanshme. Në vazhdim, ajo edhe kërkesat e zëvendëskryeministres Edita Tahiri për BE-në lidhur me këtë çështje, i vlerësoi të njëanshme.

Në fund, ajo tha se ndihma e bashkësisë ndërkombëtare për zbardhjen e fatit të të pagjeturve në Kosovë është më se e domosdoshme.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan edhe deputetët: Vjosa Osmani, Glauk Konjufca, Emin Gërbeshi, Teuta Haxhiu, Hydajet Hyseni, Lutfi Haziri, Visar Ymeri, Time Kadrijaj, Xhevahire Izmaqi, Ismet Beqiri, Albulena Haxhiu, Sali Asllanaj, Afrim Hoti, Donika Kadaj-Bujupi, Jelena Bontiq, Armend Zemaj, Blerta Deliu-Kodra, Lirie Kajtazi, Ramiz Lladrovci, Sabri Hamiti, Arsim Bajrami, Nazane Breca dhe Nait Hasani

Diskutimet e plota të përfaqësuesve të grupeve parlamentare dhe të deputetëve janë dhënë të plota në transkript, që është pjesë përbërëse e këtij procesverbali.

Deputetët: Ramë Vataj, Ganimete Musliu, Teuta Sahatqija dhe Nazane Breca (pjesën tjetër të diskutimeve) i dorëzuan me shkrim.

Pikëpamjet e Qeverisë së Republikës së Kosovës në fund të interpelancës i paraqiti zëvendëskryeministria Edita Tahiri, diskutimi i plotë i së cilës është dhënë në transkript.

Në fund, në emër të propozuesit të interpelancës, deputetja Kymete Bajraktari e paraqiti tekstin e mocionit, ndërkaq i ftoi deputetët për miratimin e tekstit të mocionit.

Diskutimi i plotë i deputetes Kymete Bajraktari është dhënë në transkript.

Kryetari e hodhi në votim tekstin e mocionit të Grupit të deputetëve nënshkrues lidhur me fatin e të zhdukurve në raport me bisedimet me Serbinë, në Bruksel.

Rezultati i votimit ishte si vijon:

Për----- 55,  
Kundër----- 9,  
Abstenime----- 0.

Kryetari konstatoi se Kuvendi nxori këto:

### **R E K O M A N D I M E**

1. Duke shprehur interesimin për zbardhjen e fatit të personave të zhdukur me forcë nga forcat ushtarako-policore serbe gjatë luftës 1998-1999 në Kosovë, kërkon nga Qeveria e Republikës së Kosovës ta kushtëzojë vazhdimin e bisedimeve të mëtejshme me Serbinë me zbardhjen e plotë të fatit të tyre.
2. Kërkojmë nga të gjithë organizmat e përfshirë në procesin e zbardhjes së fatit të personave të zhdukur ta intensifikojnë punën me qëllim të identifikimit të mundshëm të mbetjeve mortore, si dhe përkrahjen në sigurimin dhe procedimin e informatave të reja.
3. Kërkojmë nga Instituti për Krime të Luftës i Republikës së Kosovës që të grumbullojë dokumente e fakte për krimet e bëra nga ushtria, policia dhe forcat paramilitare serbe në Kosovë, në periudhën kohore 1998-1999.
4. U bëjmë thirrje medimeve të shkruara dhe elektronike që ta kenë në fokus çështjen e të zhdukurve, në mënyrë më intensive dhe ta japin kontributin e tyre nëpërmjet vetëdijesimit të aktorëve ndikues, që kjo çështje të zgjidhet sa më shpejt.

\*\*\*

Në vazhdim, kryetari i hodhi në votim rekomandimet lidhur me debatin parlamentar për çështjen e personave të zhdukur, të mbajtur më 3 maj 2012.  
Rezultati i votimit ishte si vijon:

Për----- 57,  
Kundër----- 2,  
Abstenime----- 3.

Kryetari konstatoi se Kuvendi nxori këto:

### **R E K O M A N D I M E**

1. Bashkësia ndërkombëtare (BE) t'i bëjë të detyrueshme obligimet e qeverive e të shoqërive përkatëse që të bashkëpunojnë për ndriçimin e fatit të pagjeturve. Sa i takon Kosovës, janë hartuar ligje të vendit dhe janë marrë përgjegjësi ndërkombëtare.
2. Respektimi dhe zbatimi i plotë i dokumenteve zyrtare të Kuvendit të Kosovës, që e trajtojnë çështjen e personave të zhdukur, të miratuara nga Kuvendi, Ligjit për persona të zhdukur dhe ligjeve tjera që e trajtojnë këtë çështje.
3. Intensifikimi dhe mbështetja e punës së Departamentit të Mjekësisë Ligjore në identifikimin e mbetjeve mortore dhe punës në teren.
4. Hartimi i strategjisë shtetërore me planet konkrete drejt ndriçimit të fatit të personave të zhdukur.

## **5. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për marrëdhëniet e detyrimeve**

Kryetari i njoftoi deputetët për raportet dhe rekomandimet e komisioneve të përhershme dhe të Komisionit funksional raportues për Projektligjin për marrëdhëniet e detyrimeve.

Raportin me rekomandime të Komisionit Funksional për Legjislacion, e arsyetoi kryetari i këtij komisioni, z.Arben Gashi.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutoi edhe deputetja Albulena Haxhiu - në emër të GP të Lëvizjes “Vetëvendosje”.

Kryesuesi i hodhi në votim amendamentet veç e veç.

Kuvendi i miratoi këto amendamente: 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14, 15, 16, 17, 18, 19, 20, 21, 22, 23, 24, 25, 26, 27, 28, 29, 30, 31, 32, 33, 34, 35, 36, 37, 38, 39, 40, 41, 42, 43, 44, 45, 46, 47, 48, 49, 50, 51, 52, 53, 54, 55, 56, 57, 58, 59, 60, 61, 62, 63, 64, 65 dhe 66.

Pastaj, kryesuesi e hodhi në votim Projektligjin me amendamentet e miratuara, në tërësi.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

|                |     |
|----------------|-----|
| Për-----       | 48, |
| Kundër-----    | 0,  |
| Abstenime----- | 9.  |

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi e miratoi Projektligjin për marrëdhëniet e detyrimeve.

## **6. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për skemën e ndihmës sociale në Kosovë**

Kryesuesi i njoftoi deputetët për raportet dhe rekomandimet e komisioneve të përhershme dhe të Komisionit funksional raportues për Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për skemën e ndihmës sociale në Kosovë.

Raportin me rekomandime të Komisionit Funksional për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale e arsyetoi raportuesja e këtij komisioni, deputetja Nazane Breca.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutoi edhe deputeti Liburn Aliu.

Kryesuesi i hodhi në votim amendamentet veç e veç.

Kuvendi i miratoi këto amendamente: 1, 2, 3, 4, 5A, 6, 7, 8, 9, dhe 10.

Pastaj, kryesuesi e hodhi në votim Projektligjin me amendamentet e miratuara, në tërësi.

Rezultati i votimit ishte si vijon:

|          |     |
|----------|-----|
| Për----- | 45, |
|----------|-----|

Kundër----- 9,  
Abstenime----- 2.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi e miratoi Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për skemën e ndihmës sociale në Kosovë.

## **7. Shqyrtimi i raportit vjetor financiar për buxhetin e Republikës së Kosovës, për vitin 2011**

Ministri i Financave, Bedri Hamza, në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës, tha se raporti të cilin po e shqyrtojmë sot është i bazuar në Ligjin për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë.

Në vazhdim, ai theksoi se rritja ekonomike për vitin 2011 ka qenë 5.3%, dhe kjo paraqet rritjen më të madhe ekonomike në krahasim me vendet e rajonit.

Më tej ai tha se performansa e mirë e institucioneve përkatëse financiare ka ndikuar që Republika e Kosovës t'i kryejë të gjitha obligimet e veta dhe në fund të vitit të ketë bilanc bankar në vlerë prej 203.6 milionë euro.

Më pas, ministri Bedri Hamza u fokusua në shtjellimin e aspekteve përmbajtjesore të këtij raporti. Ai, në fund, i ftoi deputetët për miratimin e këtij raporti.

Kryetari e hapi debatin për shqyrtimin e raportit financiar për buxhetin e Republikës së Kosovës, për vitin 2011.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan edhe deputetët: Safete Hadregjonaj - në emër të Komisionit për Buxhet dhe Financa dhe në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Hykmete Bajrami - në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Albana Fetoshi, në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”, Xhevdet Neziraj - në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Muhamet Mustafa - në emër të Koalicionit Kosova e Re, Jelena Bontiq, në emër të Grupit Parlamentar SLS, si dhe deputeti Arben Gashi dhe ministri Bedri Hamza, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryetari e hodhi në votim miratimin e raportit financiar për buxhetin e Republikës së Kosovës, për vitin 2011.

Rezultati i votimit ishte si vijon:

Për----- 36,  
Kundër----- 29,  
Abstenime----- 0.

Kryetari konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash, e miratoi raportin financiar për buxhetin e Republikës së Kosovës, për vitin 2011.

## **8. Shqyrtimi i Raportit të punës të Institutit Gjyqësor të Kosovës, për vitin 2011**

Deputeti Behar Selimi, në emër të Komisionit funksional për Legjislacion, tha se si komision e kemi shqyrtuar raportin vjetor të Institutit Gjyqësor të Kosovës, për vitin 2011, dhe kemi rekomanduar shqyrtimin dhe miratimin në mbledhje plenare.

Ai në fund e përkrahu raportin vjetor të Institutit Gjyqësor të Kosovës, për vitin 2011.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan edhe deputetët: Safete Hadergjonaj - në emër të Komisionit për Buxhet dhe Financa, Armend Zemaj - në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Albulena Haxhiu - në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”, Donika Kadaj-Bujupi - në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Myzejene Selmani - në emër të Grupit Parlamentar të Koalicionit Kosova e Re, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi hodhi në votim miratimin e Raportit vjetor të Institutit Gjyqësor të Kosovës, për vitin 2011.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 57,  
Kundër----- 0,  
Abstenime----- 2.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash, e miratoi Raportin vjetor të Institutit Gjyqësor të Kosovës, për vitin 2011.

### **9. Shqyrtimi i Raportit të punës të Komisionit të Pavarur të Medieve, për vitin 2011**

Deputeti Idriz Vehapi, në emër të Komisionit FunkSIONAL për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media, tha se si komision e kemi shqyrtuar Raportin vjetor të Komisionit të Pavarur të Medieve për vitin 2011 dhe kemi rekomanduar shqyrtimin dhe miratimin në mbledhje plenare.

Ai, në fund, e përkrahu Raportin vjetor të Komisionit të Pavarur të Medieve, për vitin 2011.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan edhe deputetët: Safete Hadergjonaj - në emër të Komisionit për Buxhet dhe Financa, Xhevahire Izmaku - në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Sadri Ferati - në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Afrim Kasolli - në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”, Teuta Haxhiu - në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Sasha Milosavljeviq - në emër të Grupit Parlamentar të SLS-së, si dhe deputetja, Blerta Deliu-Kodra, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi e hodhi në votim miratimin e Raportit vjetor të Komisionit të Pavarur të Medieve, për vitin 2011.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 51,  
Kundër----- 8,  
Abstenime----- 2.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash, e miratoi Raportin vjetor të Komisionit të Pavarur të Medieve, për vitin 2011.

Në vazhdim, deputetja Donika Kadaj-Bujupi propozoi që Kuvendi t’i përfundojë punimet për ditën e sotme dhe t’i vazhdojë ato ditën e nesërme, më 11 maj 2012.

Kryesuesi kërkoi nga deputetët të deklarohen lidhur me propozimin e lartpërmendur.

Kuvendi e miratoi propozimin e lartpërmendur.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi i përfundoi punimet për ditën e sotme, ndërsa vazhdimin e punimeve të mbledhjes plenare e paralajmëroi për ditën e nesërme, e premte, më 11 maj 2012, në orën 10:00.

Kryesuesi e mbylli mbledhjen plenare në orën 17:35 minuta.

\*\*\*

**11 maj 2012, e premte, ora 10:00**

**Vazhdimi i mbledhjes plenare, të filluar më 10 maj 2012.**

Mbledhjen e drejtoi **Xhavit HALITI**, nënkryetar Kuvendit.

**Kryesuesi e** deklaroi të hapur vazhdimin e punimeve të mbledhjes plenare, të filluar më 10 maj 2012, e të vazhduar më 11 maj 2012.

Kryesuesi tha se për fjalë është paraqitur kryetari i GP të PDK-së.

**Adem Grabovci**, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, tha se në mbledhjen e djeshme plenare Kuvendi ka nxjerrë dy dokumente për të njëjtën çështje.

Ai u propozoi deputetëve të Kuvendit të bëhet harmonizimi i rekomandimeve të debatit për të zhdukurit, të mbajtur më 3 maj 2012, dhe i rekomandimeve nga interpelanca me zëvendëskryeministren Edita Tahiri, të mbajtur më 10 maj 2012.

Kryesuesi në vazhdim kërkoi deklaratimet e kryetarëve të grupeve parlamentare lidhur me propozimin e deputetit, Adem Grabovci.

**Ismet Beqiri**, në emër të Grupit parlamentar të LDK-së, tha se për grupin që ai përfaqëson, votimin për çështjet që e shtroi kryetari i GP të PDK-së, e konsiderojmë si çështje të përfunduar nga mbledhja e djeshme.

Duke iu referuar propozimit të kryetarit i GP të PDK-së, ne si GP i LDK-së nuk dëshirojmë që të jemi pjesë e shkeljeve që Kuvendi mund të bëjë, theksoi ai.

Ne nuk do të qëndrojmë në sallë dhe nuk do ta përkrahim mocionin e paraqitur nga z.Grabovci.

**Visar Ymeri**, në emër të Grupit Parlamentar “Vetëvendosje”, tha se grupi që ai përfaqëson nuk do të qëndrojë në sallë, nëse kthehen përsëri për votim rekomandimet, të cilat Kuvendi i ka miratuar dje.

Këto dy lloj rekomandimesh dalin nga dy diskutimet, të cilat janë bërë në Kuvend, dhe si të tilla nuk e përjashtojnë njëra-tjetrën, konstatoi ai.

**Kymete Bajraktari**, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, tha se grupi që ajo e përfaqëson e kundërshton propozimin e kryetarit të GP të PDK-së.

**Myzejene Selmani**, në emër të Grupit Parlamentar Kosova e Re, tha se grupi që ajo përfaqëson e konsideron të gabuar votimin në mbledhjen e djeshme të dy palë rekomandimeve.

Ajo e përkrahu propozimin e z.Adem Grabovcit që të nxirret një dokument i përbashkët me rekomandime.

**Sasha Milosavljeviq**, në emër të Grupit Parlamentar SLS, e përkrahu propozimin për harmonizimin e dy palë rekomandimeve, të miratuara në mbledhjen plenare, më 10 maj 2012.

**Fikrim Damka**, në emër të Grupit Parlamentar “6+”, e përkrahu propozimin për harmonizimin e dy palë rekomandimeve, të miratuara në mbledhjen plenare, më 10 maj 2012.

Në vazhdim, tri grupet parlamentare opozitare e lëshuan sallën e mbledhjeve.

Kryesuesi, më pas, konstatoi se Kuvendi nuk ka kuorum për ta hedhur në votim mocionin e paraqitur nga deputeti, Adem Grabovci.

Kryesuesi e caktoi një pauzë 15-minutëshe për konsultime me kryetarët e grupeve parlamentare.

Pas pauzës, kryesuesi konstatoi se Kuvendi përsëri nuk ka kuorum për ta hedhur në votim mocionin e paraqitur nga deputeti Adem Grabovci.

Kryesuesi i konstatoi të mbyllura punimet e mbledhjes plenare, të datës 11 maj 2012, ndërkaq tha se vazhdimi i mbledhjes plenare do të bëhet më 15 maj 2012, në orën 10:00.

Kryesuesi e mbylli mbledhjen plenare në orën 11:15 minuta.

\*\*\*\*\*

**15 maj 2012, e martë, ora 10:00**

**Vazhdimi i mbledhjes plenare, të filluar më 10 maj 2012, dhe e vazhduar më 11 maj 2012.**

Mbledhjen e drejtoi **Xhavit HALITI**, nënkryetar Kuvendit.

Kryesuesi i deklaroi të hapura punimet e mbledhjes plenare, ndërsa për fjalë u paraqitën deputeti Arsim Bajrami dhe ministri Besim Beqaj.

**Arsim Bajrami**, në emër të GP të PDK-së, tha se çështja e personave të pagjetur dhe rekomandimet që i miratoi Kuvendi i Kosovës më 10 maj 2012 nuk do të duhej të politizoheshin nga askush, as nga deputetët, e as nga grupet parlamentare, ngase kjo është plaga më e madhe e trashëguar që nga paslufta në Kosovë, ndërsa përpjekjet për zbardhjen e fatit të të pagjeturve janë një detyrim shtetëror i të gjitha institucioneve të Republikës së Kosovës.

Në fund të paraqitjes së tij, deputeti Arsim Bajrami, në emër të GP të PDK-së, propozoi që mbledhja e sotme t'i zhvillojë punimet sipas agjendës së miratuar në mbledhjen plenare të datës 10 maj 2012.

Kuvendi u pajtua me propozimin e deputetit Arsim Bajrami.

**Besim Beqaj**, në emër të Qeverisë së Kosovës, propozoi që pika e fundit nga rendi i ditës së mbledhjes së sotme - **Shqyrtimi i Propozim-vendimit të Qeverisë së Kosovës për emërimin e anëtarëve në Bordin e Zyrës së Rregullatorit të Energjisë** të radhitet e si pikë e parë në vazhdimin e mbledhjes së sotme plenare.

Kryesuesi kërkoi deklarinimin e kryetarëve të grupeve parlamentare lidhur me propozimin e lartpërmendur.

Në vazhdim, për këtë çështje diskutuan edhe deputetët: Adem Grabovci - në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Ismet Beqiri - në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Visar Ymeri - në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes "Vetëvendosje", Ardian Gjini - në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Myzejene Selmani - në emër të Grupit Parlamentar të Koalicionit Kosova e Re, Sasha Milosavljeviq - në emër të Grupit Parlamentar të SLS-së, Albert Kinolli - në emër të Grupit Parlamentar "6+", si dhe deputeti Ismet Beqiri, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Më pas, kryesuesi e hodhi në votim propozimin e ministrit Besim Beqaj.  
Rezultati i votimit ishte si vijon:

Për----- 48,  
Kundër-----33,  
Abstenime----- 1.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash, e miratoi propozimin që **Shqyrtimi i Propozim-vendimit të Qeverisë së Kosovës për emërimin e anëtarëve në Bordin e Zyrës së Rregullatorit të Energjisë** të shqyrtohet si pikë e parë e mbledhjes së sotme plenare.

#### **10. Shqyrtimi i Propozim-vendimit të Qeverisë së Kosovës për emërimin e anëtarëve në Bordin e Zyrës së Rregullatorit të Energjisë**

Deputeti Zenun Pajaziti, në emër të Komisionit FunkSIONAL për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, tha se si komision e kemi shqyrtuar Propozim-vendimin e Qeverisë së Kosovës për emërimin e anëtarëve në Bordin e Zyrës së Rregullatorit të Energjisë dhe kemi rekomanduar miratimin në mbledhje plenare.

Ministri Besim Beqaj, në emër të Qeverisë së Kosovës, e arsyetoi Propozim-vendimin e Qeverisë së Kosovës për emërimin e anëtarëve në Bordin e Zyrës së Rregullatorit të Energjisë.

Kryesuesi e hapi debatin për shqyrtimin e Propozim-vendimit të Qeverisë së Kosovës për emërimin e anëtarëve në Bordin e Zyrës së Rregullatorit të Energjisë.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan edhe deputetët: Sala Berisha-Shala - në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Ismet Beqiri - në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Visar Ymeri - në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”, Ardian Gjini - në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Myzejene Selmani - në emër të Grupit Parlamentar të Koalicionit Kosova e Re, Biserka Kostiq - në emër të Grupit Parlamentar SLS, ndërsa Albert Kinolli - në emër të Grupit Parlamentar “6+”, si dhe Sala Berisha-Shala, Ismet Beqiri dhe Teuta Sahatqija, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi e hodhi në votim miratimin e Propozim-vendimit të Qeverisë së Kosovës për emërimin e anëtarëve në Bordin e Zyrës së Rregullatorit të Energjisë.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 46,  
Kundër----- 40,  
Abstenime----- 2.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash, e mori këtë:

#### **V E N D I M**

1. Krenar BUJUPI dhe Merita KOSTARI emërohen anëtarë të Bordit të Zyrës së Rregullatorit për Energji, me mandat pesëvjeçar (5).
2. Anëtari aktual, Enver HALIMI, emërohet kryesues i Bordit të Zyrës së Rregullatorit për Energji.

## **11. Shqyrtimi i Raportit të punës të Agjencisë Kosovare Kundër Korrupsionit, për vitin 2011**

Deputeti Armend Zemaj, në emër të Komisionit FunkSIONAL për Legjislacion, tha se si komision e kemi shqyrtuar Raportin vjetor të Agjencisë Kosovare Kundër Korrupsionit, për vitin 2011, dhe kemi rekomanduar shqyrtimin dhe miratimin në mbledhje plenare.

Ai, në fund, e përkrahu Raportin vjetor të Agjencisë Kosovare Kundër Korrupsionit, për vitin 2011.

Kryesuesi e hapi debatin për shqyrtimin e Raportit vjetor të Agjencisë Kosovare Kundër Korrupsionit, për vitin 2011.

Raportin vjetor financiar të Agjencisë Kosovare Kundër Korrupsionit për vitin 2011, në emër të Komisionit për Buxhet dhe Financa, e paraqiti deputetja Safete Hadergjona.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan edhe deputetët: Arben Gashi - në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Albulena Haxhiu - në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”, dhe Ardian Gjini - në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi e hodhi në votim miratimin e Raportit vjetor të Agjencisë Kosovare Kundër Korrupsionit, për vitin 2011.

Rezultati i votimit ishte si vijon:

Për----- 48,  
Kundër----- 8,  
Abstenime----- 2.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash, e miratoi Raportin vjetor të Agjencisë Kosovare Kundër Korrupsionit, për vitin 2011.

## **12. Shqyrtimi i Propozimit të Gjykatës Supreme të Kosovës për emërimin e anëtarit në Komisionin për Kërkesa Pronësore**

Deputeti Arben Gashi, në emër të Komisionit FunkSIONAL për Legjislacion, tha se si komision e kemi shqyrtuar Propozimin e Gjykatës Supreme të Kosovës për emërimin e anëtarit në Komisionin për Kërkesa Pronësore dhe kemi rekomanduar miratimin në mbledhje plenare.

Kryesuesi e hapi debatin për shqyrtimin e Propozimit të Gjykatës Supreme të Kosovës për emërimin e anëtarit në Komisionin për Kërkesa Pronësore.

Pasi nuk pati deputetë të paraqitur për diskutim, kryesuesi e hodhi në votim miratimin e Propozimit të Gjykatës Supreme të Kosovës për emërimin e anëtarit në Komisionin për Kërkesa Pronësore.

Rezultati i votimit ishte si vijon:

Për----- 45,  
Kundër----- 0,  
Abstenime----- 8.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash, mori këtë:

## **V E N D I M**

1. Adem VOKSHI emërohet anëtar i Komisionit për Kërkesa Pronësore.
2. Mandati i anëtarit të Komisionit për Kërkesa Pronësore është një (1) vit.

### **13. Shqyrtimi i Propozimit të Qeverisë së Kosovës për emërimin e anëtarëve të Bordit të Agjencisë Kosovare të Pronës**

Deputeti Behar Selimi, në emër të Komisionit FunkSIONAL për Legjislacion tha se si komision kemi shqyrtuar Propozimin e Qeverisë së Kosovës për emërimin e anëtarëve të Bordit të Agjencisë Kosovare të Pronës dhe kemi rekomanduar shqyrtimin dhe miratimin në mbledhje plenare.

Kryesuesi hapi debatin për shqyrtimin e Propozimin e Qeverisë së Kosovës për emërimin e anëtarëve të Bordit të Agjencisë Kosovare të Pronës.

Pasi që nuk pati deputetë të paraqitur për diskutim, kryesuesi hodhi në votim miratimin e Propozimit të Qeverisë së Kosovës për emërimin e anëtarëve të Bordit të Agjencisë Kosovare të Pronës.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 44,  
Kundër----- 0,  
Abstenime----- 9.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi me shumicë votash, mori këtë

## **V E N D I M**

1. Ujup KRASNIQI dhe Ismajl OSDAUTAJ, emërohen anëtar të Bordit të Agjencisë Kosovare të Pronës.
2. Mandati i të emëruarve nga pika nr. 1. e këtij vendimi zgjat një (1) vjet.

### **14. Shqyrtimi i kërkesës së Komisionit ad hoc për amendamentimin e Ligjit për zgjedhjet e përgjithshme, për afat shtesë**

Deputeti Haki Demolli, në emër të Komisionit ad hoc për amendamentimin e Ligjit për zgjedhjet e përgjithshme, e paraqiti dhe e arsyetoi kërkesën për afat shtesë prej 3 muajve për vazhdimin e punës së Komisionit që ai e drejton.

Kryesuesi e hapi debatin për shqyrtimin e kërkesës së Komisionit ad hoc për amendamentimin e Ligjit për zgjedhjet e përgjithshme, për afat shtesë.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan edhe deputetët: Halit Krasniqi- në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Ismet Beqiri - në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Albulena Haxhiu - në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”, Donika Kadaj-Bujupi - në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Myzejene Selmani - në emër të Grupit Parlamentar të Koalicionit Kosova e Re, si dhe Ismet Beqiri, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Kryesuesi e hodhi në votim miratimin e kërkesës së Komisionit ad hoc për amendamentimin e Ligjit për zgjedhjet e përgjithshme, për afat shtesë.

Rezultati i votimit ishte si vijon:

Për----- 45,  
Kundër-----11,  
Abstenime----- 1.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash, mori këtë

## V E N D I M

Komisionit ad hoc për amendamentimin e Ligjit për zgjedhjet e përgjithshme i lejohej afati shtesë prej tre (3) muajve, për amendamentimin e Ligjit për zgjedhjet e përgjithshme në Republikën e Kosovës.

### **15. Kërkesa e Komisionit për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, për afat shtesë për ta shqyrtuar Projektligjin për parkun kombëtar “Sharri” dhe të Projektligjit për parkun kombëtar “Bjeshkët e Nemuna”**

Kryesuesi i njoftoi deputetët me kërkesën e Komisionit për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor për afat shtesë për ta shqyrtuar Projektligjin për parkun kombëtar “Sharri” dhe për Projektligjin për parkun kombëtar “Bjeshkët e Nemuna”.

Kryesuesi e hapi debatin për shqyrtimin e kërkesës së Komisionit për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor për afat shtesë për ta shqyrtuar Projektligjin për parkun kombëtar “Sharri” dhe për Projektligjin për parkun kombëtar “Bjeshkët e Nemuna”.

Pasi nuk pati deputetë të paraqitur për diskutim, kryesuesi e hodhi në votim kërkesën e Komisionit për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor për afat shtesë për ta shqyrtuar Projektligjin për parkun kombëtar “Sharri” dhe për Projektligjit për parkun kombëtar “Bjeshkët e Nemuna”.

Rezultati i votimit ishte si vijon:

Për----- 61,  
Kundër----- 0,  
Abstenime----- 0.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi mori këtë:

## **V E N D I M**

Komisionit për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor i lejohet afati shtesë prej një (1) muaji për shqyrtimin e Projektligjit për parkun kombëtar “Sharri”, si dhe të Projektligjit për parkun kombëtar “Bjeshkët e Nemuna”.

\*\*\*

Kryesuesi i konstatoi të mbyllura punimet e mbledhjes së sotme, në orën 11:40 minuta.

Kryetari i Kuvendit

**Jakup KRASNIQI**

Përgatiti: Divizioni për Çështje Plenare dhe Procedurale